



# BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

KORRIK 2021

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin korrik 2021 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në të gjitha bashkitë e vendit.

## 1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit korrik 2021 zënë 57.5 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 331.5/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 1.85/100.000 banorë. Rrethet Berat dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë muajit korrik 2021 janë raportuar 9 raste (Incidenca 0.31/100.000 banorë) të konfirmuara me Salmonelozë jotifoide. NJVKSH Shkodër ka raportuar 5 raste të konfirmuara (Incidenca 3.6/100.000 banorë) me Salmonelozë jotifoide dhe NJVKSH Korçë 4 raste të konfirmuara (Incidenca 5.2/100.000 banorë). Bashkia Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin korrik 2021 në nivel kombëtar 23 raste të konfirmuara (Incidenca 16.9/100.000 banorë).

**Tabela 1: Frekuencat dhe incidenat e sëmundjeve diarreike për muajin korrik 2021  
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste korrik 2021	Incidenca korrik 2021 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	9	0.31
Shigelozë (Disenteri bacilare)	23	0.8
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	53	1.85
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	9404	328.5
Sëmundje diarreike në total	9489	331.5

## 2. Sëmundjet e EPI

### 2.1 Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit korrik 2021 janë raportuar 31 raste (Incidenca 1.08 raste/100.000 banorë) me Tuberkuloz pulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike 27 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Rastet janë të shpërndara në të gjithë vendin përkatësisht, nga një rast në Pogradec dhe Durrës, 2 raste në Dibër, Elbasan, Lushnjë dhe Shkodër, dhe 21 raste të konfirmuara në Tiranë.

Gjatë muajit korrik 2021 është raportuar 1 rast i konfirmuar me Tuberkuloz ekstrapulmonar në Tiranë. Konfirmimi është kryer në Laboratorin e Referencës, Tiranë. Për rastin pozitiv është lajmëruar dispanseria përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pacienti ka filluar mjekimin sipas skemës përkatëse.

### 3. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit korrik 2021 janë raportuar në total 2 raste me hepatit viral (Incidenca 0.07 /100.000 banorë) nga të cilat, një rast me Hepatiti Viral A i raportuar nga NJVKSH Fier (Incidenca 0.8/100.000 banorë), dhe një rast me hepatit viral as A as B i raportur nga NJVKSH Korçë (Incidenca 1.31 raste/100.000 banorë).

### 4. HIV/AIDS

Në muajin korrik 2021 janë kryer në total 38 ekzaminime për HIV në Njësinë e Laboratorëve në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP). Nga këto ekzaminime 15 prej tyre kanë rezultuar pozitive (12 meshkuj dhe 3 femra), Incidenca 0.52 raste/100.000 banorë. Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme, një fëmi 6 muajsh dhe përkësisht grup-moshave 18 deri 61 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Elbasan, Krujë, Mirditë dhe Korçë. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur në ISHP nga QSUT (Spitali Infektiv), QKTGJ, vullnetar, laborator privat (GENIUS) dhe shoqata të ndryshme.

INSTITUTI I  
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI